



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .01.2024

**Lënda:** Përgjigje kërkesës të paraqitur nga Avokat P.Ç.  
Adresa: Rruga e Kavajës, kompleksi \_\_\_ Godina  
E-mail : @gmail.com

**TIRANË**

I nderuar z. Ç.,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, nr. 17 prot datë 05.01.2024 (tonën) dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, me anë të së cilës në referencë të nenit 11 të ligjit nr 55/2018 “Për profesionin e avokatit në RSH, pikës 1.1 të nenit 20 dhe nenit 29 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit” i ndryshuar, kërkohet vënia në dispozicion e materialeve të ish-Sigurimit të Shtetit për znj. I.R., znj. N. M., znj. R.Sh., z. S.Ç. dhe znj. M.T. (pasi për znj. S. Zh.(L.) dhe znj G.B., tashmë ju kemi informuar sipas ligjit nr. 119/2014 ), dhe në rast se ato kanë të jepet një kopje e tyre,ju informojmë se:

Së pari : Për objektin e kërkesës për informacion që i nënshtrohet nenit 29 të ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar, Autoriteti pasi është vënë në lëvizje me kërkesë nga institucionet e parashikuara nga ligji lidhur me pastërtinë e figurës së znj. I.R., znj. N. M., znj. R. Sh., z. S.Ç. dhe znj. M. T., ka kryer verifikimet në materialet arkivore që disponon.

Siç ju kemi informuar edhe më parë, Autoriteti vihet në lëvizje për verifikimin e figurës për çdo kandidat që emërohet/ngrihet në detyrë, vetëm pas një kërkesë të paraqitur nga institucioni kushtetues apo autoriteti publik, jo me kërkesë të individëve. Vetëm në kushtet kur është paraqitur një kërkesë për verifikim dhe në masën dhe për qëllimet që e lejon ky ligj, lind detyrimi i Autoritetit që *“t’i përgjigjet çdo kërkesë të institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike, lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, kur kjo kërkohet në kuadër të vlerësimit, sipas legjislacionit përkatës, të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t’u emëruar ose ngritur në detyra”* siç përcakton qartë neni 29 i ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar.

Në rastin konkret në përfundim të procedurës së verifikimit kërkuar nga Avokati i Popullit, është arritur në konkluzionin se nuk rezulton asnjë e dhënë e regjistruar në emër të pesë zyrtarëve sipas objektit të kërkesës në dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit, e në këtë kuadër ka vendosur të informojë me përgjegjësi ligjore, sipas përcaktimeve të nenit 29 të ligjit nr. 45/2015, se nuk rezulton të kenë qenë bashkëpunëtor apo të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit, dhe nuk figurojnë në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Sa më sipër nuk rezulton të ketë dosje në emër të tyre, që t’ju vihen në dispozicion.

**Vendimi i Autoritetit nr. 6, datë 17.02.2017, për pesë zyrtarët sipas objektit të kërkesës nr. 17 prot datë 05.01.2024 (tonën), është ende në fuqi.**

Së dyti : Për objektin e kërkesës me referencë nenin 19 dhe 20 pika 1/1 të ligjit nr. 45/205 i ndryshuar, kërkesa juaj, u përcoll në strukturën përkatëse për tu trajtuar në përputhje me rregullat dhe procedurat ligjore që kërkon neni specifik i ligjit nr. 45/2015.

Për ecurinë e praktikës, do të njoftoheni nga strukturat përkatëse.

**Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit**

**L. Cocoli**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Sofi Noti**